



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:018795  
Datë: 21.05.2024  
Numri i dokumentit: 05710652

**E.nr.1139/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A.Q. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Dalip Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 21.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1139/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

#### **A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1139/23, të datës 03.08.2023 e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e pagave të papaguara dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2023:018795, të dt.23.05.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës, 10.10.2023 e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit t'i transferoj shumat e përgjithshme të mjeteve prej 3,357.63 euro dhe 431.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.1139/23, më datë 21.05.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**